



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Mars 2025

Data 26.03.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.02.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025.
- 4.Projekt vendim për miratimin e planit social vendorë 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.33 datë 28.04.2023 dhe Vkb nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e komisionit të strehimit.
- 6.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Lizë Sulkuqe në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.
- 7.Projekt vendim për miratimin e tavaneve përgaditore të shpenzimeve të PBA 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025.
- 9.Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën Janar-Dhjetor 2024 dhe vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2024 i Bashkisë Vau Dejës.
- 10.Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12 mujorin e vitit 2024.
- 11.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Mars 2025, u zhvillua me datë 26.03.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepja.Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë, (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau,Marin Dodaj,Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj) korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 18 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.02.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.02.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Z.Ervis shimaj sqaron këshilltarët se këshilltarja Znj.Kristjana Kovaçi, ka munguar 6 muaj rresht në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës pa ndonjë arsye dhe konkretisht nga muaji Shtator 2025 deri në muajin Shkurt 2025 dhe mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa e, dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës”neni 21, pika 1, germa g, komisioni i mandateve ka propozuar miratimin e humbjes së mandatit të këshilltares Znj. Kristjana Kovaçi perfaqësuese e subjektit politik P.S.D.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro**

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau,Marin Dodaj,Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Vijoletë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e Tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Shkurt 2025, te perfitojne 129 familje, me 464.647leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Shkurt 2025 janë shpallur fitues, 1.002 familje, me fond 7.748.865 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 464.931 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Në këtë moment largohet nga mbledhja këshilltari Z.Marin Dodaj dhe në sallë mbesin 17 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për vazhdimin e mbledhjes.



Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj)

Z.Ervis Shimaj lexon piken katër të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e planit social vendorë 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Çuka Babani- përgjegjëse e zyrës shërbimit social, Bashkia Vau Dejës, e cila relatoi se për hartimin e planit social vendorë 2025-2028, është realizuar takim publik me grupe interesi, aktorët lokal dhe është dakortësuar lidhur me prezantimin e planit social vendorë 2025-2028. Procesi i hartimit ka përfshirë disa hapa të rëndësishëm, të cilat i paraqesim më poshtë:

- 1.Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave relevante: Të dhënat janë mbledhur nga Bashkia Vau Dejës, regjistri i gjendjes civile, statistikat kombëtare dhe raportet e institucioneve të tjera relevante për të siguruar një analizë të plotë të situatës sociale.
- 2.Konsultime me aktorët lokalë dhe shoqërinë civile: Janë zhvilluar konsultime me grupe të ndryshme të interesit, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe grupe vulnerabël, për të përfshirë pikëpamjet e tyre në hartimin e planit.
- 3.Identifikimi i boshllëqeve në shërbimet sociale: Bazuar në raportet e monitorimit dhe përvojën e institucioneve vendore, janë identifikuar boshllëqe në ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat duhen adresuar urgjentisht.
- 4.Qasje pjesëmarrëse: Komuniteti është përfshirë aktivisht në diskutime për të garantuar një përfaqësim të drejtë dhe për të zhvilluar politika sociale që janë në përputhje me nevojat e qytetarëve.

Ky plan është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të situatës sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke adresuar faktorët kyç si shkalla e varfërisë, papunësia, struktura demografike dhe aksesimi në shërbime sociale. Plani synon të plotësojë boshllëqet ekzistuese dhe të krijojë ndërhyrje të qëndrueshme për grupet më në nevojë.

Për të garantuar zbatimin efektiv të planit dhe për të monitoruar ndikimin e politikave sociale, është përfshirë një mekanizëm të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Ky mekanizëm do të mundësojë ndjekjen e progresit dhe përshtatjen e ndërhyrjeve për t'iu përgjigjur nevojave emergjente.Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Vau Dejës synon të krijojë një model të qëndrueshëm të mbështetjes sociale dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët e saj. Ky plan përfaqëson angazhimin e Bashkisë për forcimin e përfshirjes sociale dhe transparencës, duke ndihmuar në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e mbrojtjes sociale në nivel vendor. Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj,



Mark Bisha, Kastriot Shkaj, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj)

Z. Ervis Shimaj lexon piken pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.33 datë 28.04.2023 dhe Vkb nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e komisionit të strehimit.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Edmond Gjeçaj- specialist i strehimit social i cili relatton për Këshilltarët se propozojmë ndryshimin e komisionit të strehimit i miratuar me Vkb nr.33 datë 28.04.2023 dhe Vkb nr.80 datë 30.10.2023, për arsye se disa anëtarë të këtij komisioni janë larguar dhe nga ana ligjore lind nevoja e zëvendësimit të tyre, ku konkretisht emrat i keni të pasqyruar në projekt vendimin që ju kemi paraqitur për shqyrtim.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkaj, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj)

Në këtë moment merr pjesë në mbledhje këshilltari Z. Ermir Tahiri, numri total i këshilltarëve prezent në sallë bëhet 18 këshilltarë.

Z. Ervis Shimaj lexon piken gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuara Znj. Lizë Sulkuqe në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj. Aurela Deda- përfaqesuese e zyres mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social, e cila relatton për këshilltarët se Znj. Lizë Sulkuqe ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 datë 09.03.2023 "Për ngritjen e Komisionit Multidisiplinor për vlersimin e rasteve të personave që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit. Nisur sa me sipër e moshuara Lizë Sulkuqe plotëson kriteret.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri)

Z. Ervis Shimaj lexon piken shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e tavanëve përgaditore të shpenzimeve të PBA 2026-2028 për Bashkinë Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj. Elsa Tanushi-përgjegjëse e zyrës financë buxhetit, Bashkia Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se planifikimi i të ardhurave nga taksat & tarifatat është mbështetur në disa faktor, llojet e taksave, bazën e taksueshmë, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, të cilat janë të percaktuara në dokumentin "Pakete Fiskale", e cila përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajohet çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Të ardhurat e veta, që mbledhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2026-2028 parashikohen që të kenë një trend rritje për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2026-2028 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 26%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 12%, tarifa për pastrimin që zë rreth 21 %, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifatat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rreth 20%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 83% të planit të të ardhurave të Bashkisë Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri)

Z. Ervis Shimaj lexon piken tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2025.

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z. Zeqir Ujka- përgjegjës i zyrës pyjeve, Bashkia Vau Dejës, i cili relatton për këshilltarët se hartimi i projekt vendimit është bazuar në ligj dhe se për këtë vit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm miratimi i këtij projekt vendimi respektimi i të cilit çon në zvogelimin e rriskut, mbrojtjen e fondit pyjorë nga zjarret e mundshme. Projekt vendimi shoqërohet edhe me hartat e sipërfaqes së pyjeve të territorit të Bashkisë Vau Dejës. Kërkojmë nga ana juaj miratimin e projekt vendimit.



Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkaj, Vjollca Zagani, Rregjinë Shelqetja, Violetë Markolaj, Gjovana Corri, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri)

Z.Ervis Shimaj lexon piken nëntë të rendit të ditës:

Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën Janar-Dhjetor 2024 dhe vetëvlerësimin për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2024 i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Znj.Elsa Tanushi-përgjegjëse e zyres financë buxhetit, Bashkia Vau Dejës, e cila relaton për këshilltarët se për vitin 2024, Bashkia nuk ka krijuar borxhe të reja, por janë vetëm borxhet e prapambetura nga fondet e ministrive. Gjendja financiare e Bashkisë është e shëndetshme dhe po përdorim strategjinë e rritjes së të ardhurave nga viti në vit. Më hollësisht të gjitha detajet janë në materialin me të cilin jeni të pajisur.

Të gjithë këshilltarët shprehen dakortësi për raportin e monitorimit të Bashkisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024 dhe vetëvlerësimin për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2024.

Z.Ervis Shimaj lexon piken dhjetë të rendit të ditës:

Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12 mujorin e vitit 2024.

Lidhur mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12 mujorin e vitit 2024, Z Ervis Shimaj relatoi për këshilltarët se gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 48 mbledhje komisionesh me pjesëmarrjen e 112 këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme me 48 mbledhje. Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, janë mbajtur 14 Mbledhje të Këshillit Bashkiak, janë marrë në shqyrtim 108 projektvendime nga të cilat janë miratuar 97 vendime gjithsej në Këshillin Vau i Dejës, nga të cilat për 80 vendime është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër dhe 17 janë kthyer për rishqyrtim/plotësim, ndërsa 11 projektvendime janë kthyer nga këshilli për plotësim.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë mbi dhënien në përdorim apo me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor rreth 30%, pastaj vijnë vendimet në lidhje me dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 % të cilat zënë rreth 11% të vendimeve të marra në total. I gjithë dokumentacioni projekt vendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen web të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në rregjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe proces verbalet tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar të gjitha online në facebook të Këshillit Bashkiak. Jane zhvilluar 22 degjesa publike për 22 projektakte. Për aktivitetet e vitit 2024 ka shpenzuar 345.000 lek, pa honoraret e këshilltarëve.

Pika 11 Të ndryshme: Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët të diskutojnë problemet e hasura me Zv.Kryetarin e Bashkisë Z.Ervis Molla, i cili është prezent. Këshilltarët nuk kishin diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e rradhës së muajit Mars 2025 pasi këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

- | | |
|----------------------------|---------------------------|
| 1. <u>Envis Shima</u> | 16. <u>Rita Bregi</u> |
| 2. <u>Giovana Corri</u> | 17. <u>Melike Isberaj</u> |
| 3. <u>Samir Saka</u> | 18. <u>Nela Loxhane</u> |
| 4. <u>Mark Bisha</u> | 19. <u>Ermona Kola</u> |
| 5. <u>Mustafë Shkëru</u> | 20. _____ |
| 6. <u>Besmir Hoxha</u> | 21. _____ |
| 7. <u>Ermir Tahiri</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Vjollta Markolaj</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Pregjina Shela</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Norun Adaj</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Mirela Vasija</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Vjollta Zogaj</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Ornela Lleshi</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Majlinda Vronca</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Leonora Prunç</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |